



# Udhëzime për profesionistët e medias dhe gazetarët që raportojnë mbi shëndetin

# Media luajnë një rol të rëndësishëm kur bëhet fjalë për raportimin e saktë, të besueshëm dhe të përgjegjshëm për shëndetin.

Mediat dhe gazetarët luajnë një rol të rëndësishëm kur bëhet fjalë për përhapjen e lajmeve dhe informacionit shëndetësor. Raportimi i saktë në fushën e shëndetit është kritik për të informuar publikun në lidhje me çështje të rëndësishme që ndikojnë në mirëqenien e shoqërisë.

Mediat shërbejnë si një burim i rëndësishëm i njohurive për individët dhe i ndihmojnë ata të marrin vendime të rëndësishme për shëndetin e tyre, ndërkohë që ndihmojnë në ngritjen e vetëdijësimit për çështje kritike të shëndetit, si dallimet në shëndet, sëmundjet kronike jo-ngjiëtare (SjN), sëmundjet infektive, dhe kështu me radhë. Mediat kanë një rol të rëndësishëm në informimin dhe edukimin e njerëzve për të adresuar sfidën e rritjes së SjN-ve duke ngritur vetdijësimin dhe duke ofruar informacion të saktë për të ndihmuar në shprehje më të shëndetshme.

Kështu, raportimi në fushën e shëndetit i jep fuqinë qytetarëve për të mbrojtur veten nga sëmundjet e ndryshme dhe gjithashtu i mundëson ata të kenë ndikim në politikën e qeverisë në lidhje me shëndetin publik. Megjithatë, ka një përgjegjësi të madhe kur bëhet fjalë për raportimin e shëndetit. Mungesa e saktësisë në raportimin e shëndetit mund të çojë në dezinformim. Prandaj, është shumë e rëndësishme që mediat dhe gazetarët të jenë të kujdesshëm dhe të përkushtuar ndaj saktësisë dhe integritetit, pasi shëndeti është një temë shumë e rëndësishme dhe e ndjeshme.

Pra, në bashkëpunim me ekspertët dhe gazetarët me përvojë në raportimin e shëndetit, kemi përgatitur udhëzimet e mëposhtme për të siguruar që raportimi mbi shëndetin të jetë i saktë, i besueshëm dhe i përgjegjshëm.

## Verifikoni burimet dhe saktësinë e tyre

01

Para se të përdorni burimet tuaja në raportim, gjithmonë verifikoni besueshmërinë dhe saktësinë e tyre. Sigurohuni që burimet që po përdorni janë ekspertë në fushën e tyre ose vijnë nga organizata të njohura, si institucione akademike, institucione shëndetësore, profesionistë të njohur të mjekësisë, ose studime të vlerësuara.

## Shmangni sensacionalizmin

02

Shmangni idetë e sensacionalizmit, ose krijimin e titujve dhe përmbajtjes alarmante. Gjithmonë qëndroni te faktet dhe përdorni një gjuhë të përgjegjshme gjatë raportimit dhe komunikimit, për të parandaluar panikun ose dezinformimin e panevojshëm.

## Kuptoni temën mbi të cilën raportoni dhe bazën shkencore të saj

03

Investoni kohë në kuptimin e temës dhe bazës shkencore të temës shëndetësore që po trajtoni. Temat e shëndetit mund të jenë komplekse. Sigurohuni që t'i prezantoni ato në një mënyrë që audienca ta kuptojë më lehtë. Sigurohuni të ofroni kontekstin dhe informacionin bazë kur është i nevojshëm. Përdorimi i dëshmive shkencore bën artikullin më të besueshëm dhe më informativ për lexuesin.

## Ofroni kontekst mbi temën që trajtoni

04

Sigurohuni që audiencës tuaj t'ju ofroni kontekst më të gjerë të sfidave shëndetësore, duke përfshirë statistika relevante dhe pasojat potenciale në të ardhmën.

## Përdorni gjuhë të thjeshtë

05

Përdorni një gjuhë të qartë dhe të drejtpërdrejtë që mund të kuptohet lehtë nga një audiencë e gjerë. Evitoni zhargonin mjekësor që mund të jetë i vështirë për të kuptuar dhe të shkaktojë keqkuptim.

## Respektoni integritetin dhe etikën

06

Gjithmonë merrni miratimin e personave të cilët i intervistoni ose fotografoni në mjediset shëndetësore për të mbrojtur privatësinë dhe konfidencialitetin e tyre.

## Mbani qëndrim neutral

07

Përfshini shumë perspektiva kur raportoni ose trajtoni një çështje të caktuar, për të ofruar një qëndrim neutral rreth temës. Evitoni të promovoni vetëm një anë të historisë, ose edhe pikëpamjet të njëanshme, dhe sigurohuni që pikëpamjet të përfaqësohen në mënyrë të drejtë.

## Verifikoni faktet dhe korigjoni gabimet

08

Verifikoni me kujdes të gjitha informacionet dhe burimet para se të publikoni artikullin tuaj ose të raportoni. Nëse identifikoni gabime, përpiquni t'i korigjoni ato në kohë dhe me transparencë.

## Parandaloni konfliktet e interesit

09

Evitoni konfliktet potenciale të interesit, qofshin ato financiare ose të tjera, që mund të ndikojnë në raportimin tuaj. Ndiqni standardet etike, duke përfshirë ndershmërinë, drejtësinë, përgjegjshmërinë, objektivitetin dhe konfidencialitetin.

## Ofroni informacion dhe udhëzime

10

Kur është e përshtatshme, sigurohuni të ofroni informacion ose udhëzime që mund të ndihmojnë publikun të marrë vendime të informuara për shëndetin dhe mirëqenien e tyre, si për shembull informacionet mbi masat parandaluese ose oraret e vaksinimit.

## Evitoni diskriminimin

11

Mos përmendni gjininë e njerëzve, aftësinë e kufizuar, moshën, orientimin seksual, statusin martesor, dhe kështu me radhë, nëse këto nuk janë të nevojshme për raportimin, pasi këto referenca shpeshherë shkaktojnë diskriminim. Përdorni gjithashtu një gjuhë të respektueshme dhe evitoni përdorimin e stereotipeve të dëmshme.

## Përfshihuni me audiencën

12

Kur raportoni, sigurohuni të ofroni platforma vizuale ose narrative për lexuesit ose audiencën që kërkojnë sqarime ose informacione shtesë.

## Bashkëpunoni me ekspertë të shëndetit dhe profesionistë të tjerë nga institucione të ndryshme

13

Bashkëpunoni me profesionistë të shëndetit dhe profesionistë të tjerë nga institucione të ndryshme, kur është e mundur, për të garantuar saktësinë, kredibilitetin dhe relevancën e raportimit tuaj

## Raportime vizuale

14

Fotografia duhet të jetë qartë e lidhur me tekstin. Duhet të paraqesë diversitet (gjinor, mosha, etj.) dhe të evitojë riprodhimin e stereotipave. Merrni miratimin e personave të fotografuar. Bëni foto kreative (për shembull, njerëz duke punuar së bashku ose foto individuale të personave në vend të fotove grupore ose ndërtesave të zbrazëta, etj.).

## Angazhimi i lexuesit

15

Përdorni "të gjitha shqisat" për të angazhuar audiencën, (për shembull, tingulli) kështu mund të krijoni një përvojë më të mira dhe realiste për audiencën tuaj.

Këto udhëzime për gazetarët në raportimin mbi shëndetin janë zhvilluar si rezultat i një punëtori dy-ditore me gazetarë mbi raportimin etik në fushën e shëndetit, i organizuar si një pjesë e ngjarjes ndërkombëtare "Simpoziumi për Sëmundjet Kronike Jo-Ngjitëse", i cili u organizua në Kosovë në shtator 2023. Për më shumë, vizitoni [www.ncdsymposiumkosovo.org](http://www.ncdsymposiumkosovo.org)

Punëtorin për gazetarët e organizuan projektet "Kujdesi Shëndetësor i Qashtëm dhe Cilësor" (AQH) dhe "Shërbimet Shëndetësore të Integruara" (IHS), të dyja iniciativat e përbashkëta mes Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës dhe Qeverisë Zvicerane.

Largim nga përgjegjësia: Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes projekteve AQH dhe IHS, të zbatuara nga Swiss Tropical and Public Health Institute. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC.